

STATUTI I SHOQERISE Nardi Tekstil

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar Sh.p.k. **Nardi Tekstil** eshte krijuar sot me 30.08.2023 sipas Statutit te perpiluar dhe nenshkruar nga ortakut :

Z. Nardi Xhixha , I biri i Ymer ,e datelindjes 08.12.1988 shtetas shqiptar , lindur dhe banues ne Nickel, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me numer personal **I81208014L**. Ne cilesine e "Ortakut themelues te shoqerise " Shpk, me vullnet te lire , te plote e te sinqerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Bisnesit ", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin **Nardi Tekstil** (me poshte e quajtur "Shoqeria")

KREU

Neni 1

Krijimi

Shoqeria **Nardi Tekstil** , eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti iuridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne QKB.

Kontributi i ortakeve perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Ortaket gezojne secili kuoten e vet ne shoqeri, ne perpjesetim me kontributin qe ka dhene ne kapital.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne : " **Durres Nickel NIKEL Rruga Abaz Ulliri, ndërtesë private, 1 katëshe, zona kadastrale nr. 2795, me numer pasurie 1.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese se pergjithshme.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

- *Veprimtari te ndryshme ne fushen e tregtise*
- *Tregti Tekstile (Cope edhe produkte tekstile)*
- *Mobilieri*
- *Import edhe eksport Tekstiles*
- *Tregtim paisje Tekstile*
- *Sherbim Tekstiles (Veshje si edhe Montime)*

Neni 5

Kohezgjatia

Shoqeria dote zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kuotat e kapitalit themeltar zoterohen 100% te kapitalit me 1 (nje) kuote nga ortaku Nardi Xhixha me 1 kuote me 100 % = (100. 000 !eke)

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshrne. Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta)

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet me vendim te Asamblese se Pergjithshrne duke kotnribuar ne para ose me ane te kontributeve ne natyre, dhe ne sherbime si dhe nga fitimet e shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit themeltar ne nje vlere me te vogel se ajo e percaktuar ne nenin 6 te ketij statuti, e ben te detyrueshme marrjen e nje vendimi prej shoqerise per zmadhimin e kapitalit themeltar te pakten deri ne vleren minimale.

Ne rast moszbatimi te kerkesave te ketij paragarfi, çdo person i interesuar mund te kerkoje ne rruge gjyqesore prishjen e shoqerise. Kjo prishje nuk mund te shpallet, ne qofte se rregullimi eshte bere ne ditën kur gjykata mblidhet per te marre vendim.

Neni 8

Trans ferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes ;
- c) trashegimise ;
- y) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave , deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit , sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e Pergjithshme eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statudit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyquar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme, vendos per çeshtje si:

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te regjistruar;
- y) percaktimin e shperblimeve
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te ...

Te gjitha vendimet e marra nga asambleja e pergjithshme regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise ;
- b) shpemdarrjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- y) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- d) thirrjen e mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

Neni 10

Administrimi

Administratori i shoqerise eshte **Z. Nardi Xhixha**, emeruar ne kete detyre per nje afat 5 vjecarme te drejte riprertitje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Neni 11

Kompetenca

1

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- 9) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shpemdarrjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- d) krijojte nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryeje regjistrimet dhe dergojte ne dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashkohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

Administratori eshte i detyruar te therrase mbledhjen e asamblese se pergjithshme edhe ne rastet kur:

sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara,

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem.

Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shtetore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakëve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nenermjet akteve qe jepen ne pernuthie me shikim.

rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Neni 12

Pergjegjessite

Administratori eshte pergjegjjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja e Pergjithshme qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese. Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veqante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim ;
- 9) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per 9do veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

Nese administratori vepron ne kundersiztim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje 9do fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidar. Ne menyre te veqante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundersiztim me dispozitat e ligjit, Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e meposhtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet ;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shpemandan aktivet shoqerise;
- 9) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 13

Viti Financia

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Me perjashtim te vitit te pare financiar qe fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 4

Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Pergjithsme, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve te shoqerise vendos rreth shpërndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e asamblese se pergjithshme.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe asamblese se pergjithshme per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 16

Te ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas veçimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, Asamblese se shoqerise. Te cilat mund te kalojne dhe per zmadhimin e kapitalit.

Neni 17

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne çdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- 9) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Asambleja e Pergjithshme merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ". Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga Asambleja e Pergjithshme.

Nese Asambleja e Pergjithshme nuk merr nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likujdues.

Neni 18

Likujduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij. Nese shoqeria emeron me shume se nje likuidues, pervevse kur akti i emerimit parashikon se ata veprojne vevmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojne bashkerisht te drejtat e detyrimet sipas ketij ligji. Likujduesit mund te autorizojne njerin prej tyre te kryeje veprime te nje kategorie te posavme.

Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te treteve, ne perputhje me percaktimet e ligjit. Likujduesi u nenshtrohet mbikeqyrjes se ortakeve dhe administratorit.

Neni 19

Te drejtat e detyrimet e fikuiduesit

1. Detyra e likujduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.

2. Likujduesi mund te kryeje edhe veprime te reja tregtare, per mbylljen e nje veprimi te papefunduar.

3. Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", likuiduesit verejne se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojne proceduren e likuidimit e t'i kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.

Likujduesi pergatit nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne vastin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne çastin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedura e likuidimit zgjat me shume se nje vit, likuiduesi pergatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore te shoqerise. Bilancet ne shoqerine kolektive dhe komandite miratohen nga ortaket e tjere, ndersa ne shoqerite aksionare apo nga ato me pergjegjesi te kufizuar miratohen nga asambleja e pergjithshme.

Neni 20

Perfundimi i fikuidimit

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon regjistrimin e shoqerise, ne perputhje me seksionin V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"

Neni 21

Bashkimi

Dy ose me shume shoqeri mund te bashkohen nepermjet:

1. Kalimit te te gjitha aktiveve e pasiveve te njerës ose me shume prej shoqerive, qe quhen shoqerite e perthithura, te nje shoqeri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqeria perthithese, ne kembim te aksioneve apo kuotave te kesaj shoqerie. Ky proces quhet bashkim me perthithje.

2. Themelimit te nje shoqerie te re, tek e cila kalohen te gjitha aktivet e pasivet e shoqerive ekzistuese, qe bashkohen ne kembim te aksioneve apo kuotave te shoqerise se re. Ky proces quhet bashkim me krijim i nje shoqerie te re.

Neni 22

Ndaria

Nje shoqeri mund te ndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme, duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume shoqerive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shoqeria qe ndahet, vleresohet e prishur.

Per ndarjen e shoqerise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve 216 deri ne 225 te ligjit 9901 date 14.04.2008.

Shoqerite, qe fitojne pasurite e shoqerise qe ndahet, quhen shoqeri pritese dhe pergjigjen ne menyre solidare per detyrimet e kesaj te fundit.

Regjistrimi i ndarjes se shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ka si pasoje kalimin te shoqerite pritese te te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise qe ndahet, ne perputhje me raportin e ndarjes, te percaktuar ne marreveshjen e ndarjes.

Ky kalim sjell pasoja per marredheniet ndermjet shoqerive, si dhe per palet e treta; berjen e aksionareve/ortakeve te shoqerise qe ndahet aksionare apo ortake te nje ose me shume shoqerive pritese, ne perputhje me raportin e ndarjes, percaktuar ne marreveshjen e ndarjes; vleresimin e shoqerise qe ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, sipas seksionit V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23

Shnderrimi

Shoqeria mund ta ndryshoje formen e vet li gjore, nepermjet shnderrimit te saj ne shoqeri aksionare.

Shnderrimi nuk sjell pasoja mbi te drejtat e detyrimet, qe shoqeria ka marre persiper ndaj te treteve.

Neni 24

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, dote zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 25

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26

Dispozita perfundimtare

Ky Statut u redaktua ne 4 kopje me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe, dhe pasi iu lexua ortakeve themeltar te shoqerise, nenshkruhet me vullnetin e tyre te lire nga ortaket themelues.

ORTAKU THEMELUES

Nardi Xhixha

NARDI XHIXHA

